

Performanca dhe Impakti i Veprimtarisë Audituese të Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror Administratës së Lartë Publike Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm për vitin 2016

Në datën 30 Janar 2017, Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror Administratës së Lartë Publike Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm, zhvilloi në ambientet e Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, analizën vjetore të vitit 2016, me temë “Performanca dhe impakti i veprimtarisë audituese të Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror Administratës së Lartë Publike Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm, përgjatë vitit 2016”.

Në këtë analizë, përveç audituesve të departamentit, morën pjesë dhe Prof. Dr. Dhori Kule Dekan i Fakultetit të Ekonomisë, Prof. As. Dr. Hysen Çela nga IEKA, Drejtuesja e Open Data, Aranita Brahaj, Pedagogje të Universitetit dhe përfaqësues të Shoqërisë Civile.

Ka disa vite që analizat vjetore shikohen si një instrument komunikimi me stafet akademike, shoqërinë civile dhe median të arritjeve më të mira të vitit që mbyllet dhe një reflektim mbi sfidat audituese për vitin 2017, por jo vetëm. Analiza e Departamentit u hap nga znj. Naço në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm, e cila në fjalën e saj theksoi rëndësinë që



ka ky lloj komunikimi për nivelin e transparencës së synuar dhe llogaridhënies së pretenduar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, nën kornizën e re institucione që po konturon nën projektin e binjakëzimit të financuar nga projekti IPA.

Më pas me një fjalë përshëndetëse duke theksuar rolin e rëndësishëm që ka marrë Kontrolli



i Lartë i Shtetit, në rritjen e besimit të qytetarëve duke forcuar luftën ndaj rasteve korruptive dhe abuzimeve me fondet publike, Dekani i Fakultetit të Ekonomisë Prof. Dr. Dhori Kule u shpreh për nevojën e bashkëpunimit me stafet akademike në interes të përgatitjes së brezave të rinj të specialistëve të fushës së auditimit dhe jo vetëm.

Aktivitetin e përshëndeti edhe drejtuesja e ODA, Znj. Aranita Brahaj duke theksuar nevojën për përfshirjen e audituesve në shkrime dhe publikime informativë për publikun e gjërë me tregues të qartë sidomos lidhur me fushën e prokurimeve publike. Bashkëpunimi shikohet si një urë komunikimi midis audituesit të thjeshtë dhe qytetarit që pret të shikojë se si përdoren paratë nga ata për të cilët ai “qytetari i thjeshtë” ka votuar. Në vijim përshëndeti

Prof.Dr. Hysen Cela, si përfaqësues i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, duke theksuar se të dy trupat audituese si të KLSH dhe ato të IEKA-s kanë një objektiv të njëjtë të japin siguri të arësyeshme që raportohet mbi standarde dhe që pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë të transaksioneve dhe ngjarjeve që ndoshin në një mjedis ekonomik, në këtë kontekst bashkëpunimi i shërben misionit që ka audituesi i jashtëm publik. Pas përshendetjeve u kalua në leximin e raportit të aktivitetit të Departamentit duke prekur treguesit kryesorë sasiorë dhe cilësor me të cilët u mbyll vitit 2016. Analiza u realizua edhe duke përcaktuar nivelin e treguesve të performancës bazuar në strukturën e treguesve të ofruar në literaturën dhe praktikën e Institucioneve homologe, shoqëruar këtë analizë me vlerësimin e risqeve që kërkënojnë objektivat departamental për vitin 2017. Analiza u pasua nga referime nga drejtoret e drejtorive, kryeaudituesit dhe u përfshi nga diskutime konstruktive sidomos në drejtim të zhvillimit të metodologjive të auditimit dhe teknikave të vlerësimit të riskut të nevojshme për të rritur efektivitetin dhe efikasitetin e punës së audituesve tanë. Risia e kësaj analize ishte reflektimi mbi punën e zhvillimit personal si një instrument që promovohet fuqishëm në Kongresin e XXII të INTOSAI-it, Abu Dhabi. Rritja dhe forcimi i kapaciteteve të brendshme nuk është vetëm një funksion i brendshëm institucional por duhet parë si sfidë edhe individualenë këtë mënyrë sinkronizimi i objektivave institucionale me ato personale co në ecjen përpara dhe krijimin e stafeve kompetente dhe mjaft sfiduese ndaj kërcënimeve që ka ky profesion.

Më pas u vijua me prezantimin e rezultateve të Kontrollit të Cilësisë për auditimet e ushtruara gjatë vitit 2016, nga Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror Administratës së Lartë Publike Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm, prezantim i cili u krye nga z. Pullumb Beqiraj, anëtar i grupit të Kontrollit të Cilësisë.

Pasi u diskutuan sfidat e vitit 2017, si derivate të zhvillimit strategjik institucional, u kalua në referimin e punimeve të realizuara nga brezi i ri i departamentit, bazuar në publikimet e realizuara gjatë vitit 2016 nga KLSH.